



Jeto jetën tënde më të shëndetshme.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS

NYC | **YOUNG MEN'S
INITIATIVE**



Skanojeni këtë kod QR me celular
për ta hapur këtë broshurë në internet!



RUANI LIDHJET. NA NDIQNI.

www.nychealthandhospitals.org

Një udhëzues për kujdestarinë



NYC
HEALTH+
HOSPITALS





Çfarë ndodh kur fëmija im bëhet 18 vjeç?

Pas ditëlindjes së 18-të ju nuk jeni më kujdestar ligjor i personit. Sipas ligjit, të gjithë personat nga 18 vjeç e lart prezumohen të aftë. Ligjërisht, *aftësia* përkufizohet si aftësi për të marrë vendime në lidhje me shëndetin, financat dhe fusha të tjera të rëndësishme të jetës.

Në lidhje me shëndetin, aftësia përcaktohet si aftësi për të dhënë *pëlqim të informuar* për trajtim mjekësor. Pëlqimi i informuar është aftësia për të kuptuar të gjitha përfitimet dhe rreziqet në lidhje me trajtimin mjekësor. Nëse mendoni se fëmija juaj nuk ka aftësi të japë pëlqim të informuar, mund të kërkonti kujdestarinë edhe pas ditëlindjes së 18-të. Kjo mund të mbrojtë dhe të ndihmojë fëmijën tuaj të rritur kur të marrë përkujdesje mjekësore.

Çfarë është kujdestaria?

Kujdestaria i jepet ligjërisht një prindi ose të rrituri të besuar nga gjykata. Është e drejta ligjore për marrjen e vendimeve për një person tjetër që është "i paaftë" të marrë vendime për veten të cilat janë në interesin e tij më të mirë. Të gjithë personat konsiderohen të aftë pasi bëhen 18 vjeç. Në mjekësi, *aftësia* përkufizohet si aftësi për të dhënë pëlqim të informuar ose aftësia e një personi për të kuptuar plotësisht kujdesin për të cilin bien dakord të marrin.

Nëse fëmija juaj bëhet 18 vjeç dhe ju ende mendoni se i duhet ndihmë për marrjen e vendimeve mjekësore, ju ose një i rritur i besuar mund të zgjidhni si kujdestari i tyre ligjor për ta mbrojtur. Vlerësimet duhen bërë nga një mjek dhe një psikolog për të vlerësuar aftësinë e fëmijës suaj të rritur.

Kush gëzon të drejtën të bëhet kujdestar ligjor?

Në shtetin e Nju-Jorkut cilido person mbi moshën 18-vjeçare dhe shtetas i ligjshëm i SHBA-së gëzon të drejtën e veprimit si kujdestar. Kujdestari ligjor i një të mituri është zakonisht prindi i të miturit, por mund të jetë edhe një i afërm apo një i rritur i besuar. Personat me precedent penal mund të mos e gëzojnë të drejtën për të vepruar si kujdestarë.

Procesi i marrjes së kujdestarisë

Kujdestaria e një të mituri

Për t'u bërë kujdestar, duhet:

- + Të paraqisni kërkesë për kujdestari.
- + Që fëmija juaj të vlerësohet nga një mjek i licencuar dhe një psikolog i licencuar në lidhje me aftësinë e fëmijës suaj në lidhje me vendimet e natyrës mjekësore.

Nëse vendoset se fëmija juaj nuk ka mundësi të japë pëlqim të informuar për vendimet mjekësore, do të zhvillohet një seancë dëgjimore ku do të zgjidhet kujdestari ligjor.

Llojet e posaçme të kujdestarisë

Kujdestaria e përkohshme jepet në situata emergjence kur një person nuk ka mundësi të marrë vendime për veten. Kujdestaria e përkohshme mund të jepet menjëherë dhe zgjat deri në 60 ditë në shtetin e Nju-Jorkut.

Kujdestaria zëvendësuese i jep një personi të drejtën e kujdestarisë së përkohshme të një të mituri kur prindi nuk mund të kujdeset për të miturin. Kjo ndodh rëndom kur prindi është i sëmurë apo ka vdekur.

Të gjithë informacionin që nevojitet për paraqitjen e kërkesës mund ta gjeni në faqen e internetit të Dorëzimi Elektronik i Dokumenteve i Gjykatave të Shtetit të Nju-Jorkut (New York State Courts Electronic Filing, NYSCEF) si më poshtë:

<http://www.nycourts.gov/courthelp//Guardianship/basics.shtml>

Fjalori

I kujdesur: Personi për të cilin merr vendime kujdestari. Mund të jetë i mitur, person me paaftësi zhvillimore ose i rritur i paaftë.

I rritur i paaftë: Një person mbi moshën 18-vjeçare që nuk është i aftë të marrë vendime për veten.

Kujdestar: Një person nga 18 vjeç e lart që ka fuqinë për të marrë vendime për arsimin, financat dhe kujdesin mjekësor të një fëmije, një të rrituri të paaftë apo një të rrituri me paaftësi zhvillimore.

Kujdestari: E drejta që i jep ligji një personi për të marrë vendime për arsimin, financat dhe kujdesin mjekësor të një fëmije, një të rrituri të paaftë apo një të rrituri me paaftësi zhvillimore.

Kërkesë për caktim kujdestari: Dokumentet që nevojiten për t'u bërë kujdestar i një të mituri, të rrituri të paaftë apo të rrituri me paaftësi zhvillimore.

Ndërmjetës shëndetësor: Personi që zgjedh dikush për të marrë vendime në lidhje me kujdesin shëndetësor për të nëse nuk mund t'i marrë vetë këto vendime.

Paaftësi zhvillimore: Një rrethanë që mund të kufizojë aftësinë e dikujt për të dhënë pëlqim të informuar. Kjo rrethanë lind në fëmijëri dhe mund të ketë lidhje me nxënien, gjuhën, sjelljen dhe/ose zhvillimin fizik.

Pëlqim i informuar: Leje e dhënë pas të kuptuarit të plotë të rrezikut dhe të përfitimeve të shërbimeve të marra.

